



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

RREGULLORE
PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE, SI DHE DEKLARIMIN E
PASURIVE NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE NË
INSTITUCIONIN E KOMISIONERËVE PUBLIKË

Miratuar nga Mbledhja e Komisionerëve Publikë me vendim nr. 10, datë 30.7.2018

KREU I

RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Baza ligjore

Rregullorja “Për parandalimin e konfliktit të interesave dhe deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Institucionin e Komisionerëve Publikë bazohet në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, dhe në aktet ligjore përkatëse të miratuara në bazë të tyre.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është deklarimi dhe mbajtja e përgjegjësive për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, si dhe garantimi i një vendimmarrjeje transparente, të paanshme, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut nga zyrtarët e Institucionit të Komisionerëve Publikë, si dhe ushtrimi i funksioneve nga punonjësit e Institucionit të Komisionerëve Publikë jo në kushtet e konfliktit të interesave.

Neni 3

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, mjeteve, mënyrave, procedurave, përgjegjësive dhe kompetencave për deklarimet e pasurive, si dhe identifikimin, deklarimin, regjistrimin, trajtimin, zgjidhjen, dhe sanksioneve të aplikuara në rastet e konfliktit të interesave.

Neni 4

Përkufizime

1. “Konflikt i interesit” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

Konflikti i interesit përfshin edhe disa përkufizime të tjera, për lloje të ndryshme të shfaqjes së tij, si më poshtë:

a) “Konflikt faktik i interesit” është gjendja në të cilën interesat privatë të zyrtarit ndikojnë, kanë ndikuar ose mund të kenë ndikuar në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij zyrtare.

b) “Konflikt në dukje i interesit” është gjendja në të cilën interesat privatë të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësive të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë.

c) “Konflikt i mundshëm i interesit” është gjendja në të cilën interesat privatë të zyrtarit mund të shkaktojnë në të ardhmen shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje të interesit, nëse zyrtari do të përfshihej në detyra apo përgjegjësi të caktuara.

ç) “Konflikt rast për rast i interesit” është gjendja me konflikt interesi, në njërën nga tri llojet e mësipërme, që shfaqet rast për rast dhe lidhet me një vendimmarrje të veçantë.

d) “Konflikt i vazhdueshëm i interesit” është gjendja në të cilën konflikti i interesit mund të shfaqet në mënyrë të përsëritur dhe/ose të shpeshtë në të ardhmen.

2. “Zyrtar” është çdo person që kryen detyra dhe ushtron funksione publike në Institucionin e Komisionerëve Publikë.

3. “Epror i një zyrtari” është një zyrtar tjetër, një njësi organizative brenda institucionit publik, drejtuesi më i lartë i institucionit publik ose një organ i këtij institucioni, që ka kompetenca emëruese, drejtuese, urdhëruese, vlerësuese ose kontrolluese, të drejtpërdrejta mbi këtë zyrtar ose që i janë dhënë kompetenca të caktuara për zbatimin e këtij ligji.

4. “Person i lidhur me një zyrtar” është çdo person fizik ose juridik, i cili rezulton të ketë pasur ose të ketë lidhje interesi, pasurore ose vetjake jopasurore me zyrtarin, sipas pikës 11 të nenit 3, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

5. “Parim i proporcionalitetit”, sipas pikës 12 të nenit 3, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, është raporti ndërmjet rëndësisë së detyrave, përgjegjësive dhe kompetencave të një zyrtari, me masat për parandalimin e konfliktit të interesave, raport në të cilin sa më të rëndësishme të jenë detyrat, përgjegjësitë dhe/ose kompetencat e tij, aq më të shumta janë kufizimet e interesave vetjakë.

Neni 5

Fusha e zbatimit

1. Fusha e zbatimit të kësaj rregulloreje përfshinë norma të detyrueshme për t’u zbatuar nga:

a. Çdo zyrtar i Institucionit të Komisionerëve Publikë që ndodhet në pozicione, ka përgjegjësi, kryen detyra ose ushtron kompetenca të llojeve konkrete, të përcaktuara shprehimisht në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar.

b. Çdo zyrtar tjetër i Institucionit të Komisionerëve Publikë, i cili ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese në një vendimmarrje, duke përfshirë çastet paraprake dhe çastin e fundit të procesit vendimmarrës.

ç. Personat e lidhur në masën dhe mënyrën e përcaktuar në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, dhe në nenin 30 të Kodit të Procedurave Administrative.

2. Çdo zyrtar i Institucionit të Komisionerëve Publikë mbart detyrimin për të garantuar paanësinë duke deklaruar dhe shmangur çdo situatë konflikti interesi sipas përcaktimeve të nenit 27, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar.

Neni 6

Çastet paraprake të vendimmarrjes

Për qëllimet e kësaj rregulloreje, në përputhje me udhëzimin e ILDKPKI-së nr. 239, datë 2.2.2006, “Për kuptimin e çasteve paraprake dhe thelbësore në një vendimmarrje”:

a. vendimmarrje për një akt do të vlerësohet, në çdo rast, çasti i fundit i procesit vendimmarrës, gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit;

b. vendimmarrje për një akt do të vlerësohen edhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes, sipas germës “a” të kësaj pike, të cilat janë thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese për përmbajtjen përfundimtare të aktit, që përfshijnë, por nuk janë të kufizuara si më poshtë:

i. hartimin e projektaktit nga zyrtari ose zyrtarët dhe dorëzimin organit apo zyrtarit kompetent për vendimmarrje;

ii. dhënien e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontributi tjetër të dokumentuar, për këtë projektakt nga zyrtarë të tjerë, brenda apo jashtë institucionit;

iii. dhënien e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontributi tjetër të dokumentuar nga çdo zyrtar si pasojë e kërkesave, pretendimeve apo informacioneve të subjekteve të interesuara për këtë projektakt;

iv. dhënien e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontributi tjetër të dokumentuar të çdo zyrtari me kompetencë për të vendosur përfundimisht për aktin;

v. përfshirjen e çdo dokumenti paraprak, ndërmjetës dhe/ose shoqërues të një vendimmarrjeje për një akt ose kontratë që lidhet kryesisht me organizimin, të ardhurat, shpenzimet,

strategjitë, burimet njerëzore, funksionet, detyrat e përgjegjësitë administrative pa praninë e të cilit nuk do të vendosej dhe mbështetëj përmbajtja përfundimtare e projektaktit ose projektkontratës në tërësinë e tyre;

vi. çdo rast tjetër në përputhje me specifikat konkrete e përkatëse të misionit e të veprimtarisë së Institucionit të Komisionerëve Publikë.

Neni 7

Kompetenca thelbësore dhe përcaktuese për një akt

1. Një zyrtar ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese për një akt, nëse pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i tij në vendimmarrjen për këtë akt, sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje, përcaktojnë përmbajtjen e aktit.

2. Si kompetencë thelbësore e përcaktuese e një zyrtari për një akt, përfshihet, në secilin nga çastet paraprake të mësipërme të vendimmarrjes, mundësia për të ndikuar mbi vendimmarrjen që buron nga:

a. roli zyrtar urdhërues, propozues, këshillues, zbatues ose kontrollues i ushtruar, që rrjedh nga pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi në përgatitjen, negocimin, propozimin, këshillimin, miratimin, administrimin, kontrollin ose ekzekutimin e një akti apo kontrate;

b. çdo shkak tjetër në përputhje me specifikat konkrete e përkatëse të funksionit e të veprimtarisë së zyrtarëve të Institucionit të Komisionerëve Publikë.

3. Pavarësisht nga përcaktimet e pikave të mësipërme të kësaj rregulloreje përbën çast paraprak të vendimmarrjes apo kompetencë thelbësore e përcaktuese për një akt ose kontratë çdo rast i vlerësuar si i tillë nga autoriteti përgjegjës i Institucionit të Komisionerëve Publikë, i emëruar si i tillë me urdhër të posaçëm të Komisionerëve Publikë, si dhe nga zyrtarët - eprorë në këtë institucion.

4. Në secilin prej çasteve të mësipërme, zyrtari, pjesëmarrës në vendimmarrje, me kompetencë thelbësore dhe përcaktuese, është i detyruar të deklarojë, në zbatim të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, nëse ka një interes privat që mund të shkaktojë rënien në konflikt interesi të çfarëdo lloji.

5. Në të njëjtat raste, eprori mund t’i kërkojë zyrtarit të deklarojë rast pas rasti interesat privatë në zbatim të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

6. Në rastet e vlerësimit të rrezikut të mundshëm për rënien në konflikt interesi të zyrtarit veprohet sipas dispozitave të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, si dhe nenit 16 dhe 27 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 8

Interesat privatë

1. Interesat privatë të një zyrtari janë ata interesa që parashikon neni 5 i ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, e më konkretisht:

- a. të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre;
- b. çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile;
- c. dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale;
- ç. negocime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit apo negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës;
- d. angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie, që krijojnë të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër;
- dh. marrëdhënie:
 - i. familjare apo të bashkëjetesës,
 - ii. të komunitetit,
 - iii. etnike,
 - iv. fetare,
 - v. të njohura të miqësisë apo të armiqësisë,
- e. angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendur në shkronjat e mësipërme të këtij neni.

2. Kufizimet e interesave privatë, të përcaktuara shprehimisht në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, zbatohen në mënyrë joshteruese nga dispozitat e këtij ligji, së bashku me kufizimet e të njëjtit interes privat, të përcaktuara shprehimisht në një ligj tjetër, sipas parimit që zbatohet ai kufizim që është më i rreptë.

3. Nëse në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, në lidhje me një interes të caktuar privat të një zyrtari nuk është përcaktuar ndonjë kufi sasior i kufizimit të këtij interesi, ndërsa në një ligj tjetër i njëjti interes, me qëllim parandalimin e konfliktit të interesave, kufizohet shprehimisht sipas një kufiri sasior, atëherë ky kufizim zbatohet edhe për kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, dhe anasjelltas.

4. Vlerësohet shkak për lindjen e konfliktit të interesit çdo lloj interesi privat i zyrtarit nga ata të përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, çdo lidhje apo gërshetim ndërmjet dy a më shumë prej tyre, nëse për shkak të këtij interesi ose për shkak të daljes jashtë kufizimeve të detyrueshme të këtij interesi shfaqet një gjendje me konflikt interesi, sipas përkufizimeve të pikave 1 e 4 të nenit 3, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, apo gjendemi para rasteve të papajtueshmërisë së funksionit të parashikuar në ligje të tjera.

KREU II
PROCEDURAT DHE MJETET PËR IDENTIFIKIMIN DHE REGJISTRIMIN
E KONFLIKTEVE RAST PËR RAST TË INTERESAVE

Seksioni 1
Identifikimi dhe regjistrimi i interesave në kushtet e konflikteve
rast për rast të interesave

Neni 9
Deklarimi rast për rast i interesave privatë të zyrtarit

1. Çdo zyrtar, sipas përcaktimit të këtij termi në pikat 2 dhe 3 të nenit 4 të kësaj rregulloreje, në ushtrimin e kompetencave apo në kryerjen e detyrave të tij publike, në bazë të njohjes së tij dhe në mirëbesim, detyrohet të bëjë vetëdeklarim paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesave të tij privatë, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti interesi.
2. Deklarimi rast për rast i interesave privatë të zyrtarit bëhet çdo herë, kur kjo kërkohet nga organi epror (aneksi nr. 2). Deklarimi, si rregull, duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi kërkohet dhe bëhet sa më shpejt të jetë e mundur.
3. Vetëdeklarimi ose deklarimi me kërkesë bëhet me shkrim, kur zyrtari ose punonjësi përfshihet në një vendimmarrje për një akt.
4. Komisionerët Publikë dhe komiteti *ad hoc*, në bazë të vetëdeklarimit të zyrtarit të institucionit, si dhe në bazë të të dhënave që ka, merr masat e nevojshme që të shmangë emërimin e një zyrtari në pozicione në të cilat mund të lindin ose ka konflikte interesash. Në këtë rast merren masa që zyrtarit të mos i ngarkohen detyra që mund të çojnë në shfaqjen e një konflikti të mundshëm interesash dhe, në rast të kundërt, merren masa për largimin e zyrtarit nga detyra.

Neni 10
Identifikimi i interesave privatë të zyrtarit nga persona të tretë

1. Ofrimi i informacionit për interesat privatë të zyrtarit në Institucionin e Komisionerëve Publikë, është:
 - a. detyrë e çdo zyrtari që ka dajeni;

b. e drejtë e palëve të interesuara dhe e çdo personi që ka dijeni dhe që ka një interes në përgjithësi e që përputhet me qëllimin e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

2. Burime të tjera informacioni për interesat privatë të një zyrtari mund të jenë edhe ato burime të parashikuara në nenin 9, të ligjit 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

Neni 11

Lëshimi i autorizimit nga zyrtari

1. Institucioni i Komisionerëve Publikë vë në dispozicion të zyrtarëve të tij modelin e autorizimit, në formë e në përmbajtje, që këta duhet të lëshojnë (aneksi nr.1).

2. Autorizimi dorëzohet në autoritetin përgjegjës të Institucionit të Komisionerëve Publikë, i cili e administron atë gjatë gjithë periudhës që zyrtari është në marrëdhënie pune në institucion.

Neni 12

Autoritetet përgjegjëse për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e gjendjeve të konfliktit të interesave

1. Autoriteti qendror përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI).

2. Autoriteti ose strukturat përgjegjëse për zbatimin e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar dhe të kësaj rregulloreje, sipas hierarkisë janë:

- a. Komisionerët Publikë;
- b. Kancelari;
- c. Drejtori i Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun;
- d. Drejtori i Drejtorisë Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse;
- e. Autoriteti Përgjegjës.

3. Autoriteti Përgjegjës në Institucionin e Komisionerëve Publikë, i cili zbaton detyrat e përcaktuara në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar dhe në nenin 13 të kësaj rregulloreje, ngrihet me Urdhër të Komisionerëve Publikë (Aneksi nr.4), me përbërje si më poshtë poshtë:

- a. Drejtori i Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse;
- b. Specialisti i burimeve njëzore;
- c. Specialisti redaktor gjuhësor.

4. Në përshkrimin e pozicionit të punës, për detyrën e Autoritetit Përgjegjës të Institucionit të Komisionerëve Publikë, të vendoset si kriter dhe njohja e ligjeve për deklarimin e pasurive dhe ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit. Për emërimin, lëvizjen apo largimin nga funksioni të Autoritetit Përgjegjës, njoftohet paraprakisht Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së.

Neni 13

Detyrat e autoritetit përgjegjës të Institucionit të Komisionerëve Publikë

1. Autoriteti Përgjegjës i Institucionit të Komisionerëve Publikë kryen detyrat sipas udhëzimit të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së nr. 1, datë 27.6.2014, “Për krijimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e strukturave të autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave, në institucionet publike”, si dhe çdo detyrë tjetër sipas parashikimeve të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar dhe nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, dhe çdo akti nënligjor të miratuar në zbatim të tyre.

2. Autoriteti Përgjegjës i Institucionit të Komisionerëve Publikë veçanërisht kryen detyrat:

a. Mbledh dhe dokumenton interesat privatë të zyrtarëve të institucionit (aneksi nr. 5).

b. Shpërndan dhe mbledh autorizimet e detyrueshme për t’u lëshuar nga zyrtarët e Institucionit të Komisionerëve Publikë, sipas nenit 10, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, dhe nenit 11 të kësaj rregulloreje.

c. Krijon regjistrin përkatës dhe mban regjistrimet rast për rast të konfliktit të interesit (aneksi nr. 3).

ç. Bazuar në regjistrimin dhe vlerësimin e interesave privatë të zyrtarëve të Institucionit të Komisionerëve Publikë, u sugjeron atyre dhe/ose eprorëve të tyre çështjet dhe momentet kur zyrtarët, dhe/ose eprorët e tyre duhet të tregohen të kujdesshëm për parandalimin e:

i. konfliktit rast për rast të interesit (faktik, në dukje dhe të mundshëm);

ii. konfliktit të vazhdueshëm të interesit (aneksi nr. 6).

d. Kryen, me autorizim të Komisionerëve Publikë, verifikim të interesave të deklaruar apo të padeklaruar të zyrtarëve dhe punonjësve të këtij institucioni, duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë që i jep ligji dhe informon për këtë, sipas rastit, Komisionerët Publikë.

dh. Mbështet eprorin e zyrtarit në vlerësimin e kryerjes së padrejtë të detyrave për shkak të konfliktit të interesit, në marrjen e masave disiplinore apo në propozimin për vendosjen e gjobave në rast kundërvajtjesh administrative të zyrtarit, në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

e. Informon, këshillon e trajnon zyrtarët në lidhje me këtë ligj, me të drejtat e detyrimit e tyre dhe me parandalimin sa më të mirë të konfliktit të interesave.

ë. Merr masa për të siguruar aksesin e informimit të publikut me të dhënat personale të zyrtarëve dhe me dokumentet e tjera zyrtare që lidhen me konfliktin e interesit, duke u bashkërenduar me strukturën përgjegjëse për të drejtën e informimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

f. Në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun:

i. Marrin masa për të lehtësuar ankimin administrativ të palëve të interesuara në lidhje me aktet e marra në konflikt interesi, zyrtarëve përgjegjës, si dhe mbështesin institucionin në ndërmarrjen e hapave ligjorë për dëmshpërblimin e palëve të treta të dëmtuara dhe kalimin e barrës së dëmshpërblimit te zyrtarët përgjegjës.

ii. Orientojnë, vlerësojnë, kontrollojnë apo kryejnë hetim administrativ në lidhje me konfliktin e interesit të zyrtarëve të Institucionit të Komisionerëve Publikë, në përputhje me ligjin kuadër, këtë rregullore dhe urdhrat e miratuar nga ILDKPKI-ja.

iii. Shtrojnë çështje dhe kërkojnë këshilla nga ILDKPKI-ja për zbatimin e këtij ligji, si dhe për përmirësime në ligje të tjera, kur kjo ka të bëjë me çështjen e konfliktit të interesave.

iv. Marrin masa për të miratuar rregulloret e brendshme.

g. Mbështet zyrtarët e Institucionit të Komisionerëve Publikë në kryerjen e deklaramit periodik të interesave.

gj. Bën me dije zyrtarët dhe punonjësit e Institucionit të Komisionerëve Publikë për çdo këshillë apo udhëzim të ILDKPKI-së.

h. Ndjek e zbaton detyra të tjera që i ngarkohen sipas kësaj rregulloreje ose urdhrave të Komisionerëve Publikë.

Neni 14

Regjistri i konflikteve rast pas rasti të interesave

1. Për regjistrimet e konflikteve rast për rast të interesave të zyrtarëve të Institucionit të Komisionerëve Publikë krijohet regjistri me të njëjtin emër (aneksi nr. 3).

2. Ky regjistër administrohet nga autoriteti përgjegjës i Institucionit të Komisionerëve Publikë.

Neni 15

Regjistrimet rast pas rasti të konflikteve të interesave

Autoriteti përgjegjës, për çdo rast të shfaqjes së një konflikti rast për rast të interesit, regjistron identitetin e zyrtarit të Institucionit të Komisionerëve Publikë, interesat privatë të tij, shkak për konflikt interesi, thelbin e konfliktit, palët e interesuara, burimin e të dhënave, mënyrën e marrjes dhe të verifikimit të tyre, si dhe vendimin që është marrë, mbështetur në këto të dhëna, përfshirë edhe vendimet e marra nga eprorët, institucionet eprore ose nga gjykatat.

Neni 16

Administrimi i dokumentacionit nga autoriteti përgjegjës

1. Dokumentacioni i përdorur nga autoriteti përgjegjës, në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar dhe në zbatim të kësaj rregulloreje, është dokumentacion zyrtar. Zyrtari i emëruar si autoritet përgjegjës, me rastin e emërimit dhe largimit të tij, duhet të marrë në dorëzim zyrtarisht nga Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse dhe të bëjë dorëzimin e plotë të dokumentacionit pranë kësaj drejtorie, e cila më pas ia dorëzon zyrtarit të ri që merr detyrën e autoritetit përgjegjës.

2. Me qëllim administrimin sa më të mirë të dokumentacionit nga autoriteti përgjegjës, krijohen dhe mbahen nga ky autoritet përgjegjës dosje të veçanta, me përmbajtje si vijon:

- **Dosja nr. 1, me titull: "Për aktet ligjore dhe nënligjore", duhet të përmbajë:**

Institucioni i Komisionerëve Publikë, bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 4, Tiranë, info@ikp.al

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
 - Ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative”;
 - Ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë” (të ndryshuar);
 - Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (të ndryshuar);
 - Ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
 - Ligjin nr. 8503, datë 30.6.1999, “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”;
 - Ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”; ligjet të tjera në varësi të veprimtarisë së institucionit publik;
 - Komentarët ligjorë nr. 1, 2, 3, 4, 5 (dhe të tjerë që miratohen në vijimësi) të ILDKPKI-së;
 - Manuale shpjeguese dhe trajnimi, nr. 1, 2, 3, 4 (dhe të tjerë që miratohen në vijimësi) të ILDKPKI-së;
 - Urdhra dhe udhëzime të ILDKPKI-së ose të çdo institucioni tjetër të ngarkuar me ligj për këtë qëllim, si për shembull:
 - Udhëzimin nr. 7, datë 21.2.2006, “Për funksionet që mbartin detyrimin për deklarim”;
 - Udhëzimin nr. 239, datë 2.2.2006, “Për kuptimin e çasteve paraprake dhe thelbësore në një vendimmarrje”;
 - Udhëzimin nr. 622, datë 30.11.2012, “Për ngritjen, funksionimin dhe përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave”.
- **Dosja nr. 2, me titull “Për identifikimin dhe regjistrimin e konfliktit rast për rast të interesave”, duhet të përmbajë:**
 - Regjistrin e konfliktit rast për rast të interesave, në formë libri, i sekretuar;
 - Autorizimet e plotësuara nga zyrtarët për deklarimin rast për rast të interesave;
 - Deklaratat e plotësuara nga zyrtarët për konfliktin rast për rast të interesave;
 - Informacionet e marra nga publiku, nga media apo nga burime të tjera të ligjshme për konfliktin rast për rast të interesave të zyrtarëve;
 - Verifikimet e bëra në regjistrat publikë dhe privatë.
 - **Dosja nr. 3, me titull “Për regjistrimin e deklarimeve periodike të pasurive dhe interesave të zyrtarëve që kanë detyrimin për deklarim pranë ILDKPKI-së”, duhet të përmbajë:**
 - Regjistrin themeltar alfabetik, me emrat dhe funksionet e zyrtarëve që deklarojnë në ILDKPKI;
 - Kopje të njoftimeve ndaj zyrtarëve për deklarim dhe konfirmimet e tyre;
 - Kopje të shkresave për deklaratat e dorëzuara në ILDKPKI;
 - Kopje të formularit për listën e zyrtarëve, që nuk kanë deklaruar në afat dhe shkaqet e mosdeklarimit në afat;
 - Librin për dorëzimin e deklaratave të pasurisë, ku zyrtari nënshkruan për datën e dorëzimit.

Seksioni 2
Identifikimi, regjistrimi, kufizimi i interesave privatë

Neni 17

Zyrtarët që mbartin detyrimin për deklarim periodik të interesave privatë

1. Deklarimi i interesave privatë periodikë të zyrtarëve të Institucionit të Komisionerëve Publikë bëhet në përputhje me kërkesat e kreut I të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar.
2. Zyrtarët e Institucionit të Komisionerëve Publikë, të cilët janë të detyruar të bëjnë deklarime periodike të interesave privatë sipas nenit 3, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, janë:
 - a. Komisionerët Publikë;
 - b. Këshilltarët ligjorë dhe ekonomikë;
 - d. Kancelari.
3. Në përputhje me nenin nr. 7, pika 5, nenin 21 dhe 22 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, mbartin detyrim për deklarim të interesave privatë periodikë bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët madhorë të zyrtarëve të Institucionit të Komisionerëve Publikë, të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, edhe kur këta të fundit nuk janë në të njëjtën gjendje familjare me zyrtarin.
4. Çdo zyrtar i Institucionit të Komisionerëve Publikë, i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, në rast largimi nga funksioni dhe në rast se nuk është më subjekt i deklarimit të interesave privatë periodikë në institucion ose kur kalon në një pozicion që nuk mbart detyrimin për deklarim, është i detyruar që, brenda 15 ditëve nga data e largimit nga funksioni, të plotësojë dokumentin zyrtar: “Deklaratë pas largimit nga funksioni”.
5. Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse, në rast se zyrtari nuk plotëson detyrimin ligjor të pikës 4, të këtij neni, të kësaj rregulloreje dhe të ligjit 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, nuk duhet të bëjë dorëzimin e librezës së punës, të librezës së kontributeve shoqërore, të çdo dokumenti tjetër, si dhe pagimin e pagës së fundit dhe/ose shpërblimeve që mund t’i takojnë zyrtarit, në rast se ky i fundit nuk plotëson këtë detyrim ligjor.

Neni 18

Mbrojtja për dhënien e informacioneve

1. Çdo shtetas, i cili ofron informacion të bazuar për rastet e konfliktit të interesave të padeklaruar nga zyrtarët e Institucionit të Komisionerëve Publikë, përfiton mbrojtje të veçantë administrative, si më poshtë:

a. Zyrtari i Institucionit të Komisionerëve Publikë për të cilin jepet informacion, nuk mund të ushtrojë asnjë kompetencë administrative me efekte ndëshkuese mbi shtetasin informues dhe as të bëhet pengesë për fitimin e të drejtave të ligjshme nga ky i fundit për shkak të dhënies së informacionit.

b. Kur marrja e masës ndaj shtetasit që informon përcaktohet nga një shkak tjetër ligjor, ajo merret vetëm nga një zyrtar tjetër i Institucionit të Komisionerëve Publikë, që qëndron në marrëdhënie varësie vertikale mbi zyrtarin, për të cilin është dhënë informacioni.

2. Nga parashikimi i pikës 1, germa b, të këtij neni bën përjashtim rasti kur marrja e masës administrative bëhet në kushtet kur konflikti i vetëm i interesit i pashmangshëm i zyrtarit të Institucionit të Komisionerëve Publikë është ai në dukje kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a. kur zyrtari i Institucionit të Komisionerëve Publikë është i pazëvendësueshëm në ushtrimin e funksioneve;

b. kur vetëpërjashtimi i zyrtarit të Institucionit të Komisionerëve Publikë është i pamundur, sepse është i pamundur delegimi i kompetencave të tij tek një zyrtar tjetër, për shkak të ligjit apo për shkak të situatës;

c. kur vendimet e zyrtarit të institucionit, sipas rregullimeve me ligj, nuk i nënshtrohen miratimit, revokimit ose shfuqizimit nga një organ epror;

d. kur nuk është i mundur transferimi a tjetërsimi i interesit i privat, për shkak të natyrës së tij (si lidhje familjare, komunitare apo lidhje të tjera);

e. kur nuk ka kuptim, që për një rast konflikti të tillë, zyrtari i Institucionit të Komisionerëve Publikë të japë detyrimisht dorëheqjen nga funksioni.

Neni 19

Kufizimi i interesave privatë për parandalimin e konfliktit rast për rast të interesit për çështje të veçanta

1. Komisionerët Publikë, këshilltarët ligjorë dhe këshilltarët ekonomikë:

a. nuk mund të ushtrojnë asnjë funksion tjetër publik;

b. nuk mund të ushtrojnë asnjë veprimtari tjetër fitimprurëse, me përjashtim të mësimdhënies, akademike dhe shkencore, duke përfshirë në të shkrimin, analizën, studimin, publikimin apo dhënie leksionesh dhe kryerje trajnimesh, për çështje ligjore, si dhe të marrin pjesë në veprimtari që lidhen më çështje ligjore, administrimin e drejtësisë dhe çështje të tjera të lidhura me to;

c. nuk mund të jenë anëtarë të partive politike dhe nuk mund të marrin pjesë në veprimtaritë e tyre;

d. nuk mund të zotërojnë në mënyrë aktive aksione ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare, të çdo forme.

2. Kancelari, Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun, si dhe Drejtori i Drejtorisë Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse:

- a. nuk mund të ushtrojnë asnjë funksion tjetër publik;
- b. nuk mund të ushtrojnë asnjë veprimtari tjetër fitimprurëse, me përjashtim të mësimdhënies;
- c. nuk mund të jenë anëtarë të partive politike dhe nuk mund të marrin pjesë në veprimtaritë e tyre;

d. nuk mund të ketë interesa privatë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të përcaktuar në nenin 5 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisive të tij publike.

3. Çdo person, i cili ka informacion mbi ekzistencën e shkaqeve të konfliktit të interesit të përmendur në pikën 1, të këtij neni, njofton menjëherë mbledhjen e Komisionerëve Publikë.

Neni 20

Ndalimi i marrjes së dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale

1. Është e ndaluar që një zyrtar në Institucionin e Komisionerëve Publikë të kërkojë, të pranojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, për veten, për familjen, të afërmit, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij në institucion, nga një individ, person fizik ose juridik privat, nga subjekte të deklaramit të interesave privatë periodikë në ILDKPKI, kur kjo mund të shkaktojë lindjen e një konflikti interesi të çdo lloji ose që ndikon, ose duket sikur ndikon në paanshmërinë e kryerjes së detyrës a është ose duket sikur është shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës zyrtare.

a. “Dhurata”, sipas kësaj rregulloreje ka të njëjtin kuptim të përcaktuar në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 714, datë 22.10.2004, “Për veprimtarinë e jashtme dhe dhënien e dhuratave gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”.

b. Nuk konsiderohen si dhurata, në kuptim të këtij neni, dhuratat të cilat i ofrohen zyrtarit si pasojë e lidhjeve farefisnore apo njohjeve personale që ai ka me dhuruesit, si edhe në rastin kur është e qartë se dhurata nuk ka asnjë lidhje me pozicionin dhe cilësinë si nëpunës i administratës publike të personit që merr dhuratën.

2. Zyrtari nuk duhet që, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të japë dhurata ose të ndërmjetësojë për të dhënë dhurata për një zyrtar të një niveli më të lartë apo të afërm të tij dhe as të kërkojë ose të pranojë dhurata nga zyrtarë të një niveli më të ulët ose të afërm të tij, për shkak të cilësive dhe raporteve zyrtare.

3. Rregullat e mësipërme nuk zbatohen në rastin e ftesave të zakonshme apo kur janë të ftuar punonjës ose kolegë të tjerë, të mikpritjes tradicionale, dhuratave me vlerë simbolike apo tradicionale dhe të mirësjelljes, brenda kufijve normalë të traditës, zakoneve dhe praktikës së përditshme, të cilat nuk krijojnë dyshime për paanësinë e nëpunësit.

4. Pranimi dhe vlerësimi i dhuratave bëhet sipas rregullave të përcaktuara në nenin 23 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 714, datë 22.10.2004, “Për

veprimtarinë e jashtme dhe dhënien e dhuratave gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”.

5. Në asnjë rast, zyrtari i Institucionit të Komisionerëve Publikë nuk duhet të pranojë dhurata në vlerë monetare.

6. Përgjithësisht vetëm rastet e përcaktuara me akte të organeve kompetente, të cilat lejojnë pranimin e dhuratave apo trajtimeve preferenciale për arsye protokollare.

Neni 21

Prania dhe kufizimi i interesave privatë të personave të lidhur me zyrtarin

1. Person i lidhur me zyrtarin e Institucionit të Komisionerëve Publikë, për kufizimet e interesave privatë të zyrtarëve, të përcaktuar në nenet 19 e 20 të kësaj rregulloreje janë përkatësisht:

a. bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja fëmijët në moshë madhore, prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/ja;

b. çdo person fizik ose juridik, i cili, në lidhje me dhuratën, favorin, premtimin ose trajtimin preferencial, luan rolin e ndërmjetësit a të shkëmbyesit të interesave të lindur nga ky veprim.

2. Ndalimet dhe kufizimet për zyrtarin e institucionit, të përcaktuara në këtë rregullore, zbatohen edhe për personat e lidhur me të, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

3. Për sa i përket kufijve të zotërimit të aksioneve ose të pjesëve në kapital, për zyrtarin e institucionit dhe personin e lidhur me të zbatohen drejtpërdrejt parashikimet e nenit 24, pikat 4 e 5 dhe nenit 35, pikat 2 e 3, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

4. Personi i lidhur me zyrtarin nuk mund të ushtrojë veprimtari si person fizik tregtar ose ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, nëse veprimtaria përputhet ose pritet me sferën e juridiksionit të zyrtarit dhe të kompetencës së tij për të vepruar, me akte individuale apo normative të nxjerra nga ai ose kur zyrtari ka rol thelbësor dhe përcaktues në nxjerrjen e këtyre akteve, të cilat krijojnë pasoja juridike, përfitime ose kosto mbi këtë person fizik apo mbi shoqëri tregtare e persona të tjerë fizikë që bashkëpunojnë ose konkurrojnë me personin e lidhur.

Kjo pikë nuk zbatohet kur plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

a) mjeti i vetëm me të cilin ky zyrtar mund të krijojë efektet e mësipërme, është një ligj ose një vendim i këshillit të bashkisë, komunës ose qarkut ose një vendim gjyqësor;

b) veprimtaria dhe/ose disa veprimtari tregtare së bashku të një personi të lidhur krijojnë një të ardhur të përgjithshme bruto vjetore që nuk tejkalon kufirin prej 10 milionë lekësh.

Neni 22

Mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave

Mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave për zyrtarët/punonjësit e Institucionit të Komisionerëve Publikë bëhen sipas kreut IV, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

Disa nga mënyrat bazë të mënjanimit të konfliktit të interesit janë:

- a) t'i kufizohen zyrtarit informacione të caktuara që lidhen me ushtrimin e funksionit të tij;
- b) të mos i ngarkohen detyra që mund të çojnë në shfaqjen e një konflikti interesash;
- c) të mos lejohet që zyrtari të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes; të rishikohen ose të ndryshohen detyrat dhe kompetencat e zyrtarit;
- d) të transferohet zyrtari në një detyrë tjetër, që shmang konfliktin e interesave;
- e) të merren masat e nevojshme për të shmangur emërimin ose zgjedhjen e një zyrtari në funksione në të cilat mund të lindin ose ka konflikte interesash;
- f) në rast të një akti të marrë në praninë e konfliktit faktik të interesit, në çdo mënyrë që kjo vihet re, të anulohen ose të revokohen aktet e marra nga zyrtari, sa më parë që të jetë e mundur dhe mundësisht para se ato të kenë sjellë pasoja;
- g) anulimi ose revokimi i aktit mund të bëhet edhe kur gjykohet se akti është marrë në kushtet e konfliktit në dukje të interesit, i cili mund të shfaqet rast për rast ose në mënyrë të vazhdueshme;
- h) anulimi ose revokimi i një akti nuk bëhet nga eprori i zyrtarit, kur ai vlerëson se pasojat që mund të vijnë nga anulimi ose revokimi i tejkalojnë dukshëm përfitimet nga ky anulim ose revokim.

Neni 23

Sanksionet

Shkeljet e detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", të ndryshuar, përbëjnë sipas rastit shkelje disiplinore, kundërvajtje administrative apo vepër penale, dhe ndëshkohen sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

Neni 24

Ndalimi i shpërdorimit të së drejtës

1. Asnjëra nga dispozitat e kësaj rregulloreje nuk mund të interpretohet sikur u jep zyrtarëve të Institucionit të Komisionerëve Publikë të drejta që të ndërmarrin ndonjë veprimtari ose të kryejnë ndonjë akt, që synon cenimin e parashikimeve dhe rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar, apo ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", si dhe ligjet e posaçme që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Komisionerëve Publikë.

2. Në çdo rast që specifikimet në këtë rregullore bien ndesh me dispozitat e përcaktuara në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar, apo ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre, këto të fundit kanë prioritet dhe zbatohen drejtpërdrejt. Gjithashtu, dispozitat e këtyre ligjeve e akteve nënligjore zbatohen drejtpërdrejt, për aq sa nuk ka specifikime në zbatim të tyre në këtë rregullore.

Neni 25

Miratimi, njoftimi, shpallja

Kjo rregullore miratohet nga mbledhja e Komisionerëve Publikë.

Pas miratimit të saj, publikohet menjëherë në faqen zyrtare të internetit të Institucionit të Komisionerëve Publikë.

Një kopje e saj i vihet në dispozicion dhe i dërgohet edhe në postën elektronike zyrtare çdo punonjësi të Institucionit të Komisionerëve Publikë.

Neni 26

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga mbledhja e Komisionerëve Publikë dhe ndryshohet vetëm me vendim të saj.

KOMISIONERËT PUBLIKË

Florian Ballhysa

Darjel Sina

Aneks nr. 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ Prot.

Tiranë më, ____ . ____ . ____

A U T O R I Z I M

Unë, i nënshkruari, _____

(emër, atësi, mbiemër)

me funksion _____

(emërtimi i funksionit dhe institucionit publik)

në datën ___/___/_____, në respekt të detyrimit tim ligjor sipas nenit 10, pika 2, si dhe nenit 41, pika 2 e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, autorizoj Institucionin e Komisionerëve Publikë që të kryejë kontroll dhe të sigurojë të dhëna vetjake për personin tim, kudo ku ato janë të regjistruara dhe që lidhen me llojet e interesave privatë të përcaktuara në nenin 5, me përjashtim të atyre të dhënave personale të përcaktuara në pikën 4, të nenit 7, të këtij ligji.

Autorizimi ka vlerë për të gjithë kohën që unë ushtroj detyrën publike, e cila është subjekt i kontrollit dhe i verifikimit sipas ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

Gjithashtu, ky autorizim ka vlerë për çdo kohë, pavarësisht nga mosvazhdimi i detyrës sime publike, por vetëm për ato të dhëna të interesave të mi privatë, të cilat mund të lidhen me ushtrimin e detyrës publike në kohën e ushtrimit të saj.

Të gjitha veprimet për të kryer kontroll dhe për të siguruar të dhëna personale, të kryera nga institucionet ose personat e autorizuar prej tyre i konsideroj sikur janë kryer nga unë vetë.

Çdo person fizik ose juridik, publik ose privat, nuk duhet t’u nxjerrë pengesë personave konkretë që posedojnë origjinalin ose kopjen e njësuar me origjinalin të këtij autorizimi e të ngarkuar zyrtarisht, sipas ligjit për të kryer kontroll dhe për të siguruar të dhëna të interesave të mi privatë. Në bazë të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, personi i ngarkuar për mbledhjen dhe verifikimin e të dhënave, që vihet në dijeni për të dhënat

personale të autorizuesit, detyrohet të ruajë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit.

Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj.

AUTORIZUESI

KOMISIONERËT PUBLIKË

Aneks nr. 2



Nr. _____ Prot.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Tiranë më, ____ . ____ . ____

D E K L A R I M

**RAST PËR RAST I INTERESAVE PRIVATË TË ZYRTARIT
NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE**

Kush mbart detyrimin për deklaram rast për rast të interesavë privatë

Të gjithë zyrtarët e përcaktuar në nenin 4 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, si dhe në rregulloren e brendshme të institucionit.

Llojet e deklaramit:

- 1- Vetëdeklaram paraprak rast për rast të ekzistencës së interesave privatë, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti interesi.
- 2- Deklaram rast për rast të interesave privatë të një zyrtari kur kërkohet nga eprori ose institucioni epror.

Të dhëna personale:

Emri	Atësia	Mbiemri	Funksioni	Institucioni
_____	_____	_____	_____	_____

Lloji i deklaramit: (Vendos X në kutizën për llojin e deklaramit.)

Me kërkesë të _____

Vetëdeklaram

Vërtetohet se deklaratimet e bëra në vijim nga unë janë të plota, të vërteta, të sakta dhe mbaj përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e tyre.

1- Përshkrimi i hollësishëm i interesave privatë që bëhen shkak për një konflikt interesi:

2- Përmbajtja e kufizimit ligjor në ushtrimin e funksioneve publike që bëhet shkak për një konflikt interesi:

3- Mënyra e zgjidhjes së konfliktit të interesave:

Data e dorëzimit të deklaratës: _____

Emri, mbiemri, nënshkrimi

Aneks nr. 3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ Prot.

Tiranë më, ____:____:____

REGJISTRI VJETOR I EVIDENTIMIT DHE ZGJIDHJES SË RASTEVE TË KONFLIKTIT TË INTERESAVE

NR.	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	FUNKSIONI	Data e evidentimit	Përshkrimi i konfliktit të interesit	Burimi i të dhënave dhe verifikimi	Mënyra dhe data e zgjidhjes së konfliktit	Shënime
1									
2									
3									
4									
5									

Shënim: Ky regjistër është pjesë e raportit vjetor për veprimtarinë e kryer në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, në të cilin duhet të evidentohen rastet e konflikteve të interesave, mënyrat e ndjekura për parandalimin ose trajtimin e tyre, rezultatet e arritura, si dhe çështjet e lidhura me deklarin periodik. Sqarimet në lidhje me rastet e konflikteve të interesave të detajohen në raportin vjetor të autoritetit përgjegjës.

Regjistri vjetor i evidentimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesave duhet të dërgohet i plotësuar në Inspektoratin e Lartë brenda datës 31 janar të çdo viti.

AUTORITETI PËRGJEGJËS

Aneks nr. 4



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. ___ Prot.

Tiranë më, __. __. __.

URDHËR

Nr. _____, dt. ____ . ____ . ____

PËR

“NGRITJEN E AUTORITETIT PËRGJEGJËS PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE”

Në mbështetje të nenit 41, pika 2, germa “b”, si dhe nenit 42, pika 3 e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, si dhe nenit 13, pikat “c” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e autoritetit përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave.
 2. Caktimin e:
 - znj/z. _____, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse;
 - znj/z. _____, me detyrë Specialist i Burimeve njerëzore;
 - znj/z. _____, me detyrë Specialist Redaktor gjuhësor;
 - si anëtarë të njësisë autoritet përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave.
 3. Drejtuesi i njësisë autoritet përgjegjës caktohet z./znj. _____. Drejtuesi i njësisë bën ndarjen e punës mes anëtarëve.
 4. Njësia e ngritur në pikën 1 të këtij urdhri si autoritet përgjegjës do të mbajë në vijimësi kontaktet me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERËT PUBLIKË

Aneks nr. 5



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Administrimi i dokumentacionit nga autoriteti përgjegjës

Për administrimin e këtij dokumentacioni, autoriteti përgjegjës duhet të mbajë dosjet e mëposhtme.

1. **Dosja nr. 1**, me titull “Për aktet ligjore dhe nënligjore”, duhet të përmbajë:
 - ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë” (të ndryshuar);
 - ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (të ndryshuar);
 - ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999, Kodi i Procedurave Administrative;
 - ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
 - ligjin nr. 8503, datë 30.6.1999, “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”;
 - ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
 - ligjet organike në varësi të veprimtarisë së institucionit publik;
 - komentaret ligjorë të ILDKPKI-së;
 - urdhra dhe udhëzime të ILDKPKI-së ose të çdo institucioni tjetër të ngarkuar me ligj për këtë qëllim;
 - botime të tjera të ILDKPKI-së.
2. **Dosja nr. 2**, me titull “Për identifikimin dhe regjistrimin e konfliktit rast për rast të interesave”, duhet të përmbajë:
 - a. regjistrin e konfliktit rast për rast të interesave, në formë libri, të sekretuar, sipas formatit të aneksit nr. 3;
 - b. autorizimet e plotësuara nga zyrtarët për deklarimin rast për rast të interesave, sipas formatit të aneksit nr. 1;
 - c. deklaratat e plotësuara nga zyrtarët për konfliktin rast për rast të interesave, sipas formatit të aneksit nr. 2;
 - d. informacionet e marra nga publiku, nga media apo nga burime të tjera të ligjshme për konfliktin rast për rast të interesave të zyrtarëve;
 - e. verifikimet e bëra në regjistrat publikë dhe privatë.
3. **Dosja nr. 3**, me titull “Për regjistrimin e deklarimeve periodike të pasurive dhe interesave të zyrtarëve që bartin detyrimin për ILDKPKI”, duhet të përmbajë:

- regjistrin themeltar alfabetik, me emrat dhe funksionet e zyrtarëve që deklarojnë në ILDKPKI, sipas formatit të aneksit nr. 7;
- kopje të njoftimeve ndaj zyrtarëve për deklarim dhe konfirmimet e tyre, sipas formatit të aneksit nr. 11 dhe të aneksit nr. 12;
- kopje të shkresave për deklaratat e dorëzuara në ILDKPKI;
- kopje të formularit për listën e zyrtarëve që nuk kanë deklaruar në afat dhe shkaqet e mosdeklarimit në afat, sipas aneksit nr. 10;
- librin për dorëzimin e deklaratave të pasurisë, ku zyrtari nënshkruan për datën e dorëzimit, sipas aneksit nr. 9.

Kujdes: Në rast largimi nga detyra të autoritetit përgjegjës, zyrtari/zyrtarët duhet të bëjnë dorëzimin e plotë të dokumentacionit të mësipërm me procesverbal dhe inventar të detajuar pranë Drejtorisë/Njësisë së Burimeve Njerëzore, e cila më pas ia dorëzon zyrtarit/zyrtarëve të rinj.

Aneks nr. 6



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ Prot.

Tiranë më, ____ . ____ . ____

DEKLARIM

**PËR KONFLIKTIN E VAZHDUESHËM TË INTERESAVE PRIVATË NGA ZYRTARI
NË USHTRIMIN E FUNKSIONIT PUBLIK**

Mbartin detyrimin për deklaram të konfliktit të vazhdueshëm të interesave privatë:

Të gjithë zyrtarët, e përcaktuar në nenin 4, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, si dhe në rregulloren e brendshme të institucionit publik.

Llojet e deklaramit:

- 1- Vetëdeklaram para fillimit të detyrës, të ekzistencës së interesave privatë, të cilët bëhen shkak për lindjen e konfliktit të vazhdueshëm të interesave.
- 2- Deklaram i interesave privatë të një zyrtari kur kërkohet nga eprori ose institucioni epror, për shkak të funksionit.

Të dhëna personale:

Emri	Atësia	Mbiemri	Funksioni	Institucioni
_____	_____	_____	_____	_____

Lloji i deklaramit: (Vendos X në kutizën për llojin e deklaramit.)

- Vetëdeklaram
 Me kërkesë të _____

**Vërtetoj se deklaramet e bëra në vijim nga unë janë të plota, të vërteta, të sakta dhe mbaj
përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e tyre.**

1- Përshkrimi i hollësishëm i interesave privatë që bëhen shkak për një konflikt interesi:

2- Përmbajtja e kufizimit ligjor në ushtrimin e funksioneve publike që bëhet shkak për një konflikt interesi:

3- Mënyra e zgjidhjes së konfliktit të interesave:

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, mbiemri, nënshkrimi

Aneks nr. 7



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ Prot.

Tiranë më, ____ . ____ . ____

**REGJISTRI THEMELTAR ALFABETIK PËR SUBJEKTET QË MBARTIN DETYRIM PËR
DEKLARIM TË PASURIVE NË ILDKPKI**

NR.	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	FUNKSIONI	Data e emërimit	Data e largimit	Data e deklarimit sipas viteve					Shënime	Alfabetiku
1													
2													
3													
4													
5													

AUTORITETI PËRGJEGJËS

Aneks nr. 8



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË**

Nr. _____ Prot.

Tiranë më, ____ . ____ . ____

**LISTA E ZYRTARËVE QË MBARTIN DETYRIM PËR DEKLARIM VJETOR TË
INTERESAVE MË 31 DHJETOR TË ÇDO VITI**

NR.	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	FUNKSIONI	INSTITUCIONI
1					
2					
3					
4					
5					

AUTORITETI PËRGJEGJËS

Shënim: Dërgohet e plotësuar në Inspektoratin e Lartë, brenda datës 15 janar të çdo viti, lista e zyrtarëve që mbartin detyrim për deklaram vjetor të interesave, me shkresë përcjellëse të nënshkruar nga titullari i institucionit.

Aneks nr. 9



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË**

Nr. _____ Prot.

Tiranë më, ____ . ____ . ____

**LISTA E ZYRTARËVE QË KANË DORËZUAR DEKLARATËN E INTERESAVE DERI
MË 31 MARS TË VITIT _____**

NR.	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	FUNKSIONI	INSTITUCIONI	DATA E DORËZIMIT TË DEKLARATËS/ NËNSHKRIMI
1						
2						
3						
4						
5						

AUTORITETI PËRGJEGJËS

Aneks nr. 10



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË**

Nr. _____ Prot.

Tiranë më, ____ . ____ . ____

LISTA E ZYRTARËVE QË NUK KANË DORËZUAR DEKLARATËN E INTERESAVE

NR.	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	FUNKSIONI	INSTITUCIONI	SHKAKU I MOSDORËZIMIT
1						
2						
3						
4						
5						

AUTORITETI PËRGJEGJËS

Shënim: Dërgohet e plotësuar në Inspektoratin e Lartë, brenda datës 15 prill të çdo viti, lista e zyrtarëve që mbartin detyrim për deklarim vjetor të interesave dhe nuk e kanë dorëzuar atë

Aneks nr. 11



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ Prot.

Tiranë më, ____ . ____ . ____

VËRTETIM

Zoti/Zonja _____, me funksion _____, në
Institucionin e Komisionerëve Publikë, më datë _____ ka dorëzuar deklarin e
interesave për periudhën _____.

Së bashku me deklarin e vet, në zarf ka vendosur edhe deklarin e bashkëshortit/es,
bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve madhorë, sipas rastit, _____ të cilët mbartin detyrim për
deklarin të interesave në institucionin e Komisionerëve Publikë.

AUTORITETI PËRGJEGJËS

Aneks nr. 12



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ Prot.

Tiranë më, ____ . ____ . ____

NJOFTIM

Zoti/Zonja _____,
me funksion _____, në Institucionin e Komisionerëve Publikë, njoftoheni se brenda datës, keni detyrimin për të dorëzuar deklarin e interesave për periudhën _____.

Së bashku me deklarin, në zarf duhet të vendosni edhe deklarin e bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve madhorë, sipas rastit, të cilët mbartin detyrim për deklarin të interesave në Institucionin e Komisionerëve Publikë.

AUTORITETI PËRGJEGJËS
